



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V.
Sesioni Pranveror.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja Nr. 03
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225
Prishtinë, më 21 janar 2015, në orën 10:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 30.12.2014;
3. Përcaktimi i Planit të Punës për muajin janar;
4. Të ndryshme.

***Kryetarja,** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë: 30.12.2014;**

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me datë: 30.12.2014, pa vërejtje.

3. Përcaktimi i Planit të Punës për muajin janar;

Flora Brovina, tha se gjatë muajit Janar ne si komision kemi vendosur që ti realizojmë dy takime ndaras me Ministrat e ministrive që i mbulojmë. Takimet do të jenë të karakterit njoftues dhe diskutim lidhur me sfidat dhe prioritetet e ministrive të tyre.

Me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale propozoj që të mbajmë me datë: 23.01.2015 ora 12:00, kurse me Ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë propozoj që takimi të mbahet me datë: 28.01.2015, ora 11:00. Në bazë të praktikës, takimet që i kemi mbajte me ministrat e kaluara ne e dimë se si rrjedhin këto takime, ministrat çdo herë na kanë prezantuar para nesh sfidat, prioritetet dhe projektet e tyre që planifikojnë ti zhvillojnë në ministrat e tyre, po ashtu ne si anëtar të Komisionit kemi të drejtë të parashtrijmë pyetje dhe të zhvillojmë një bashkëbisedim me ministrin lidhur me sfidat dhe prioritetet e ministrisë.

4. Të ndryshme.

Flora Brovina, kurse të pika të ndryshme, po ju njoftoj se disa organizata kanë shprehur gatishmërinë që të bashkëpunojnë me komisionin tonë në këtë rast të pranishëm kemi edhe përfaqësuesen e OSBE-së me të cilën kemi realizuar një takim ku kemi diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit si dhe për ndihmën që mund të na ofrojnë. OSBE na ka ofruar fillimisht një propozim që në fillim të muajit shkurt të realizojmë një punëtori ku do të punojmë bashkërisht në përgatitjen e planit të punës për Komisionin për vitin 2015, ne jemi dakorduar parimisht për datat: 03 dhe 04 Shkurt 2015 të mbajmë punëtorin në Pejë ku gjatë kësaj punëtorie do të përgatisim planin e punës për këtë vit.

Stafi mbështetës i komisionit ka përgatitur një draft plan të punës së komisionit për vitin 2015, ku është përgatitur në bazë të programit legjislativ që është dorëzuar nga ana e Qeverisë. Ne si komision do të shqyrtojmë këtë draft plan dhe do ti japim propozimet tona që të jetë një plan sa ma gjithëpërfshirës dhe i kompletuar mirëpo plani i punës siç e dimë është fleksibil dhe kur ne vlerësojmë se ka nevojë për ndryshime mund ti bëjmë ato. Komisioni jonë ka qenë një prej komisioneve që ka bërë monitorim të implementimit të ligjeve dhe kemi përvojë në këtë fushë, gjithashtu kemi realizuar shumë vizita në institucione të ndryshme. Po ashtu gjatë shqyrtimit të draft planit të punës mund të propozoni aktivitetet që mendoni se ne si komision mund ti ndërmarrim gjatë punës sonë.

Po ashtu me lejoni të ju njoftoj se organizata dhe autoritete të ndryshe kanë shprehur gatishmërinë e tyre që të kemi bashkëpunim dhe të na ofrojnë ndihmë gjatë punës sonë. Kështu që unë të premtën do të realizoj një takim me Ambasadorin e Turqisë znj. Sonogu Ozan.

Kurse sa i përket orarit të mbajtjes së mbledhjeve të komisionit në do të kemi një ndryshim sa i përket orës, mbledhjet tash e tutje komisioni do ti mbaj pra të mërkurave në ora 11:00, për arsye se deputetja znj. Shukrije Bytyqi është anëtarë ne dy komisione.

Shukrije Bytyqi, faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë koleget. Po ashtu ju falënderoj për mirëkuptim për ndryshimin orës sa i përket mbajtjes së mbledhjeve pasi që në të njëjtën orë kemi mbledhje edhe në komisionin tjetër, kështu që në të ardhmen unë do të mundem që të marr pjesë në mbledhjet e të dy komisioneve.

Time Kadrijaj, faleminderit kryetare, ne sot para nesh kemi një draft plan të punës sa për njoftim, kuptohet se plani i punës përgatitet sipas agjendës legjislative që dy ministrat kanë përgatitur. Meqenëse paskeni realizuar takim me OSOBE-në të cilat kanë shprehur gatishmërinë që të na ndihmojnë në përgatitjen e planit të punës. Përpos monitorimit dhe hartimit të ligjeve të

cilat do ti kemi ne në komision propozojë që ti planifikojmë edhe disa vizita sistematike që ti realizojmë nëpër institucione të ndryshme në ato shëndetësore varësisht prej situatave që paraqiten, sepse ne po shohim se po hasim në shumë probleme në shëndetësi edhe në sektor të ndryshëm në mënyrë që ne si komision për së afërmi të informohemi se ku qëndron problemi dhe ne të mundohemi që ti adresojmë këto probleme.

Po ashtu unë kam një propozime që të kërkojmë nga të dy ministrat që në afat çdo tre muaj të paraqesin një raport të shpenzimeve, sepse buxheti i ministrave në muajt e parë të vitit shpenzohet shumë pak kurse në muajt e fundit të vitit po bëjnë shpenzime të mëdha të buxhetit diku 70 deri 80% e buxhetit po shpenzohet në muajt e fundit, duke e marrë parasysh se po është fundi i vitit nuk kemi transparence dhe llogari sa i përket shpenzimit të buxhetit.

Flora Brovina, pikërisht është kjo një nderë çështjet që komisioni do të marrim përsipër monitorimin e shpenzimeve të buxhetit në këto dy ministri, kjo është një përvojë e re pasi që ne si komision nuk kemi bërë monitorimin sa i përket shpenzimit të buxhetit mirëpo në këtë punëtori që do të mbahet se shpejti që do të organizohet nga OSBE-ja do të diskutohet edhe për mbikëqyrje buxhetore. Komisioni do të fillojë edhe me monitorimin buxhetor ku në këtë rast do të kemi edhe përkrahjen e OSBE-së.

Njomza Emini, faleminderit kryetare, me sa pata mundësi të lexoj draft planin e punës së komisionit konsideroj se është në rregull mirëpo në këtë rast është e mirëseardhur mbështetja e organizatave ndërkombëtare me një ekspertizë që e sjellin edhe prej përvojave të tjera parlamentare se si komisionet funksionojnë çfarë planesh kanë, në normalisht se kemi specifikat tona. Nuk do të ndalem me tepër në draft planin pasi që ne do të mbajmë punëtorin dhe do ti japim propozimet tona. Sa i përket raportimit të buxhetit pajtohem me kolegën se kemi nevojë të dimë se ku po shpenzohen mjetet në çfarë programesh, normalisht në jemi për me bashkëpunua me ministrat në mënyrë që ne ti japim rekomandimet tona se çka duhet të ndryshohet edhe në projektligje. Një tjetër rekomandim është që ne si komision duhet në planin e punës ti përfshijmë edhe vizitat studimore edhe jashtë vendit pasi që mendoj se kemi çka të marrim jo vetëm nga rajoni por edhe nga vendet e Evropës që ti shohim praktikën e mira në mënyrë që gjatë shqyrtimit të ndonjë projektligji ti inkorporojmë ato praktika të mira. Kurse sa i përket tryezave janë të mirëseardhura jo vetëm organizatat ndërkombëtare por edhe ato vendore kanë çka të na ofrojnë.

Flora Brovina, pajtohem me ju pasi që buxheti i komisionit është shumë i vogël që ne me mujtë me organizu ndonjë vizitë studimore, kurse në takimet që do ti kemi me organizatat e ndryshme ne do të kërkojmë dhe mbështetjen e tyre sa i përket realizimit të vizitave jashtë vendit.

Fadil Beka, faleminderit kryetare, përshëndetje për gjithë. Edhe unë pajtohem plotësisht me ato çka u thane në veçanti janë të rëndësishme takimet me ministrat, ne jemi të vetëdijshëm se situata nuk është e mirë as në sektorin e shëndetësisë e as në atë të çështjeve sociale prandaj ne varësisht prej situatave që zhvillohen dhe problemet që paraqiten ne konsideroj se duhet ti thërrasim ministrat në takim. Është një lajm i mirë që ne si komision do të kemi mbështetjen prej shumë organizatave kjo është shumë me rendësi në veçanti prej OSBE-së është shumë me rendësi përvoja e tyre që ne të paktën të mundohemi këto përvoja ti marrim me qellim që të kemi ligje të qëndrueshme pasi që ne jemi dëshmitar se shumë shpesh po kemi plotësim ndryshimin e këtyre ligjeve.

Flora Brovina, sa i përket mbështetjes së organizatave ne gjatë takimit që kemi pasur me përfaqësuesen e OSBE-së kemi biseduar për organizimin e tryezës për migrimin e qytetarëve tanë. Neve na duhet kohe dhe studim të mirë me qellim që të japim rekomandimet tona serioze se çka mendojmë dhe si mendojmë që të adresojmë këtë çështje. Ne duhet ti japim kohe edhe

OSBE-së që të shqyrtoj mundësin e mbështetjes së kësaj tryeze ne po ashtu do të kërkojmë ndihmë edhe nga organizatat tjera si në aspakëtin financiar po edhe profesional në mënyrë që të na ndihmojnë lidhur me çështjen e migrimit që ti gjejmë arsyet dhe motivin e migrimit të qytetarëve tanë. Tryezës besoj se gjatë muajit të ardhshme do ti qasim dhe rekomandimet do ti procedojmë me tej. Kurse sa i përket takimit që është organizuar nga ana e Presidencës unë kam vërejtjet e mija pasi që ne si komision nuk kemi qenë të ftuar në këtë takim.

Time Kadrijaj, unë e kam theksuar edhe në mbledhjen e kaluar ne është mirë që të mbajmë një takim të veçanët me gjitha këto organizata dhe ato të shoqërisë civile me të cilat kemi pasur bashkëpunim edhe në mandatin e kaluar. Kemi shumë organizata që bëjnë hulumtime të shumta jo vetëm në sektorin e shëndetësisë por edhe të çështjeve sociale, po ashtu ofrojnë edhe ndihme me ekspert të ndryshëm. Bashkërisht të përgatisim një listë me ato organizata që mendojmë se mund të na ndihmojnë dhe të organizojmë një takim me to dhe të fillojmë bashkëpunimin mes nesh. Mundësisht ky takim të organizohet në fillim të shkurtit, ku masë aprovimit të planit të punës me qëllim që ne të ju prezantojmë atyre planin e punës dhe të diskutojmë mundësitë e bashkëpunimit gjatë realizimit të planit të punës.

Fikrim Damka, faleminderit kryetare. Po ashtu edhe unë mendoj se duhet të organizojmë një takim të përbashkët me donator, ne kemi disa organizata që ndihmojnë në hartimin e legjislacionit brenda Kuvendit, po ashtu kemi disa organizata që ndihmojnë vetëm në monitorim në sektorët e shëndetësisë dhe çështjeve sociale të cilat besoj se do të na ndihmojnë edhe në të ardhmen. Unë shprehi shqetësimin tim se para dy dite ka qëndruar për vizite në Kosovë Ministri i jashtëm i Austrisë, ju e dini që ne në Kosovë kemi pasur disa probleme siç janë pensionet e qytetarëve tanë që jetojnë ose kanë jetuar në Austri, fatkeqësisht që s'kemi pasur mundësi të kemi një takim me Ministrin e jashtëm të Austrisë për ti diskutuar këto probleme me të. Shpresoj se Kryeministri apo Ministrat që kanë pasur takim me të i kanë diskutuar këto probleme. Siç jeni në dijeni në mandatin e kaluar ne kemi realizuar një vizitë në Austri ku jemi takuar me kryetarin e Sindikatës dhe kemi diskutuar për këtë problem. Unë mendoj se edhe në këtë mandat të shqyrtojmë mundësitë e bashkëpunimit me Ambasadën e Austrisë të organizojmë një tryezë dhe të diskutojmë problemet e pensioneve, pra kërkojë që këtë tryezë do të vendosim edhe në planin e punës për këtë vit.

Flora Brovina, plotësisht pajtohem me ju pasi që kjo është një temë mjaft e rëndësishme për diskutim jo vetëm me Austrinë por edhe me vendet tjera. Po ashtu edhe çështja e sigurimeve shëndetësore mund të diskutohen me këto ambasada pasi që me këto ligje që janë miratuar parashihet edhe nënshkrimi i marrëveshjeve. Këto propozime gjatë shqyrtimit të draft planit besoj se do të futën edhe në planin e punës së komisionit. Ku shqyrtimi apo përgatitja e planit të punës do të bëhet në punëtorin që do të organizohet së bashku me OSBE-në me 3 dhe 4 Shkurt.

Kryetarja, andaj konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

- Komisioni vendosi që me dt: 21.01.2015 në ora 12:00, të ftoj në takim Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Arban Abrashi. Kurse me dt: 28.01.2015 në ora 11:00 të ftoj në takim Ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Imet Rrahmani.

- Komisioni vendosi se me dt:03 /04 Shkurt 2015 të mbajë një punëtori për përgatitjen e planit të punës për vitin 2015, punëtorja do të organizohet me ndihmën e OSBE-së dhe do të mbahet në Pejë.
- Komisioni vendosi që gjatë muajit shkurt pas miratimit të planit të punës të organizohet një takim i Komisionit me Organizata ndërkombëtare dhe vendore që kanë në fokus çështjet shëndetësore dhe çështjet sociale, prezantimit të planit të punës para tyre si dhe shqyrtimin e mundësive të bashkëpunimit me to me qëllim të implementimit të planit të punës.
- Komisioni vendosi që në të ardhmen të mbahet një takim me ambasadat në Kosovë me të cilat kemi diskutuar edhe gjatë mandatit të kaluar çështjet e pensioneve dhe sigurimeve shëndetësore si dhe çështjeve tjera me rëndësi.
- Organizimi i tryezës “Çështja e shpërnguljes së popullatës nga Kosova për shkaqe ekonomike”, do të organizojmë mbase të gjejmë ndonjë donatorë me qëllim që të organizohet një tryezë e formatit me të gjerë.

Kryetarja, falënderoj të gjithë për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA